



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2023:159583

Datë: 21.09.2023

Numri i dokumentit: 04704914

CP.nr.5A/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Freskim Musliu, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorëve D. A. , F. B. , R. O. , M. P. dhe D. H. , të cilët sipas autorizimit i përfaqëson av.A. B. nga Prishtina, ndaj debitorit Komuna e Fushë Kosovës, duke vendosur për kërkesën për tërheqjen e propozimit për përmbarim, jashtë seance, me datë 21.09.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përmbarimore CP.nr.5A/23, në çështjen përmbarimore ndërmjet kreditorëve të përmbarimit D. A. , F. B. , R. O. , M. P. dhe D. H. ndaj debitorit të përmbarimit Komuna e Fushë Kosovës, për shkak të tërheqjes së propozimit nga ana e kreditorëve.

A r s y e t i m

Kreditorët D. A. , F. B. , R. O. , M. P. dhe D. H. përmes të autorizuarit të tyre, me datë 11.07.2023 kanë paraqitur në këtë gjykatë propozim për përmbarim ndaj debitorit Komuna e Fushë Kosovës.

Me parashtrësën e datës 19.09.2023, i autorizuari i kreditorëve ka dorëzuar në këtë gjykatë parashtrësë për tërheqjen e propozimit për përmbarim.

Gjykata, duke u bazuar në nenin 42, parag. 1 dhe 2 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË FUSHË KOSOVË
CP.nr.5A/2023, datë 21.09.2023

Gjyqtari
Freskim Musliu

DHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk është lejuar ankesa.